



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 474 / Prot
1

Tiranë, më 19/5/2020

VENDIM

Nr. 11, datë 19.5.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 474 Prot., datë 27.04.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës datë 06.04.2020, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni/informacioni në lidhje me shkresën e dërguar në datën 30.03.2020 nga Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Sistemit Shëndetësor Dega Shkodër, në adresë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si më poshtë:

1. *A ka mbërritur ndonjëherë kjo kërkesë?*
2. *Çfarë është bërë pasi institucioni është vendosur në dijeni?*
3. *Cilat janë masat që janë marrë pas parashtrimit të këtyre kërkesave?*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit, në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, nëpërmjet e-mail-it datë 30.04.2020, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni.

Në vijim, me e-mail-in datë 06.05.2020, koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *"Kërkesa po shqyrtohet dhe po draftohet. Përgjigja do të kthehet në mënyrë shkresore tek adresa dhe të dhënat e referuara në dokumentin bashkëlidhur saj."*

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit, pavarësisht vështirësive hasura për shkak të problematikave të krijuara nga COVID-19, për kthimin e përgjigjes brenda afatit ligjor, nuk përjashton në asnjë rast Autoritetin Publik nga detyrimi për të ushtruar veprimtarinë e tij në lidhje me transparencën.

Përsa më sipër, pas konsultimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, Komisioneri, vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit *"informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".*

Ekzistenca e informacionit të kërkuar, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të tij kërkuases.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e znj. _____ ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Pranimin e ankesës nr. 474 Prot., datë 27.04.2020 të znj. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit/informacionit në lidhje me kërkesën e dërguar në datën 30.03.2020 nga Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Sistemit Shëndetësor Dega Shkodër në adresë të Minisitrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si më poshtë:
 1. A ka mbërritur ndonjëherë kjo kërkesë?
 2. Çfarë është bërë pasi institucioni është vendosur në dijeni?
 3. Cilat janë masat që janë marrë pas parashtrimit të këtyre kërkesave?, brenda datës 27. 5 .2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 19. 5 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

